



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
Ministria e Zhvillimit Rajonal  
Ministarstvo za Regionalni Razvoj  
Ministry of Regional Development

---

Datë: 09.02.2018

## **Pyetjet nga Aplikantët potencial/ Përgjigjet nga MZHR-ja**

1. A është obligativ regjistrimi i bizneseve për aplikantët e rinj?
  - *Biznesi duhet të regjistrohet pasi të jeni përzgjedhur si fitues i këtij granti;*
2. Çka me borxhet e ATK-së, dhe si trajtohen bizneset që kanë marrëveshje për shlyerje të obligimeve?
  - *Nëse kanë marrëveshje dhe i përmbahen marrëveshjes së ATK-së konsiderohen në këtë thirrje;*
3. Si duhet ti paraqesin bizneset pasqyrat financiare, pasi që disa biznese mbajnë nga dy kontabilitete (reale dhe jo-reale)?
  - *Vetëm të dhënat e paraqitura në ATK konsiderohen zyrtare;*
4. Cilat lloje të bizneseve kanë drejtë të aplikojnë?
  - *Të gjitha të tjerat përveç ato të cilat janë të specifikuara në udhëzuesin për aplikantë Pika 2.4;*
5. Sa është përqindja e lejuar për trajnime dhe sa për marketing?
  - *Për secilën prej tyre lejohet maksimum 10% e vlerës së projektit;*
6. A janë të lejueshme aplikimet për infrastrukturë?
  - *JO;*
7. A pranohet bashkëfinancimi për pagesë të punëtorëve?
  - *JO;*
8. A mund të aplikojmë nëse kemi kredi?
  - *PO;*
9. Cilat dokumente lidhur me tatimet duhet ti dorëzojmë?
  - *Dokumentet të cilat janë të specifikuara në formularin e aplikimit (Shtojca A) tek dokumentet e listuar tek lista kontrolluese;*
10. Sa do të jetë transparente ndarja e fondeve?
  - *Çdo proces i kësaj thirrje për propozime do të publikohet në ueb faqen e MZHR-së;*
11. A janë të pranueshme pajisjet e hotelierisë?

- Vetëm ato pajisje që hyjnë në kuadër të pajisjeve siç është specifikuar në udhëzuesin për aplikant pika 2.6;
12. Si është çështja sa i përket bizneseve të regjistruara por pasive (deklarimet me zero)?
- Kanë drejtë të aplikojnë varësisht prej viteve që janë të regjistruara i përkasin Lot 2 ose 3;
13. A pranohen pajisjet shitesë si kallëpet e ndryshme?
- Nëse të njëjtat janë pajisje të reja dhe shërbejnë për prodhim;
14. A mbulohet lënda e parë?
- JO;
15. A lejohen pajisjet për monitorimin e ambientit?
- JO;
16. Çka mendohet me likuiditetin?
- Shiko udhëzuesin për aplikant pikën 2.1;
17. Si bëhet alokimi i mjeteve për përfituesit?
- Përcaktohet me kontratë;
18. Çka nënkuptoni me relevancën e veprimit?
- Sa është në përputhje me qëllimet dhe objektivat e thirrjes për propozime;
19. Te loti 3, vlera maksimale e aplikimit 20,000 € është së bashku me përqindjen e bashkëfinancimit apo është granti 20,000 € + vlera e bashkëfinancimit (10-40 %)?
- Granti + vlera e bashkëfinancimit (10-40 %);
20. Me rastin e aplikimit me post a duhet dhe si mund ta shkruajmë numrin e referencës?
- Vetëm referencën: **Skema e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar“;**
21. Përveç mjeteve të punës a kemi të drejt material harxhues sa për fillim të punës?
- JO;
22. Nëse një ndërmarrje është me e vjetër se 2 vite, a do mund të aplikonte përmes Lot 2 për një shumë më të vogël sesa 10,000 EUR ( le te themi 5,000 €) apo është e detyruar të aplikoj përmes Lot 3 në bazë të viteve të operimit?
- Aplikohen rregullat sipas udhëzuesit për aplikant pika 1.5;
23. Çka e përkufizon 2 vite? A nënkupton kjo te gjithë bizneset qe janë regjistruar pas 28 Shkurt, 2016 apo pas 1 Janar, 2016?
- Data e kalkulimit të viteve merren data e lansimit të thirrjes për propozime për këtë skemë të granteve 25.01.2018;
24. Nëse një biznes ka fituar Grant gjatë 3 viteve të fundit përmes një skeme tjetër, a do favorizohen duke marrë më shumë pikë në pikën 1-Kapciteti Financiar dhe Operativ apo do jetë e kundërta dhe do favorizohen bizneset që nuk kanë marrë grante në 3 vitet e fundit?
- Kapaciteti financiar vlerësohet në bazë të raporteve/pasqyrave të deklaruara në ATK;

25. Aplikacioni duket të jetë identik me thirrjen nga ARDA në vitin 2016 - REF/KPSD-GS-2016. A kanë të drejtë aplikimi, përfituesit e asaj skeme apo janë të diskualifikuar që të aplikojnë përsëri përmes kësaj thirrje?
- *Aplikacioni nuk është i njëjtë, për këtë thirrje aplikohen formularë tjerë siç janë të publikuar në ueb faqen e MZHR-së;*
26. A mundem me aplikua për makinë për klasifikim apo për arka për mbushjen me fruta?
- *Vetëm ato pajisje që hyjnë në kuadër të pajisjeve siç është specifikuar në udhëzuesin për aplikantë pika 2.6;*
27. Në pa mundësi për të dërguar personalisht aplikimin më duhet të dërgoj me poste a kishit pas mundësi të më jepni sugjerime, si të shënohet adresa e gjitha me poste i gjithë përshkrimi teknikisht që të mos bëjmë gabime?
- *Varësisht se cilin rajon ekonomik gjendeni si biznes apo aplikantë shiko udhëzuesin për aplikantë pika 3.2;*
28. A duhet ta përshkruajmë të gjithë projektin si pjesë të veçantë apo vetëm të japim shpjegimet në kuadër të aplikacionit ku është e paraparë?
- *Vetëm formularët e përcaktuar me këtë thirrje për propozime duhet të plotësohen;*
29. Nëse keni mundësi të na sqaroni rreth plotësimit të Projeksonit Financiar Lot3, ne kemi shënuar shifrat e sakta për vitin 2017 por për vitet 2018/19 çfarë duhet të bëjmë ti shënojmë pritjet gjatë këtyre viteve pas investimit apo çfarë të shënojmë?
- *Projeksionet për 3 vitet e ardhshme, shiko plotësimet në thirrje për propozime të datës 07.02.2018 të publikuara në ueb faqen e MZHR-së;*
30. Si dhe a mund ta bëjmë aplikimin në cilëndo qendër rajonale pasi që jam nga Ferizaj?
- *Aplikimi bëhet në zyrat e AZHR-së në rajonin ekonomik të cilin veproni si në vijim: -*  
**AZHR Qendër**, përfshinë 8 komuna: Prishtina, Podujeva, Obiliqi, Fushë Kosova, Drenasi, Shtime, Lipjani dhe Graçanica;  
- **AZHR Veri**, përfshinë 7 komuna: Mitrovica, Mitrovica Veriore, Vushtrria, Skenderaj, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok;  
- **AZHR Perëndim** përfshinë 6 komuna: Peja, Klina, Deçani, Juniku, Gjakova dhe Istogu.  
- **AZHR Jug**, përfshinë 6 komuna : Prizreni, Dragashi, Rahoveci, Suhareka, Malisheva dhe Mamusha;  
- **AZHR Lindje**, përfshinë 11 komuna: Gjilani, Ferizaj, Hani i Elezit, Kaçaniku, Novobërda, Shtërpca, Kamenica, Vitia, Kllokoti, Ranillugu dhe Parteshi.
31. Përderisa nuk është bërë përmbyllja e vitit deri në Mars-Prill kur dorëzohen raportet në ATK për vitin 2017, a mjafton draft pasqyra e vitit 2017 të dorëzohet duke përfshirë edhe raportet tremujore që janë dorëzuar për vitin 2017?
- *Afati për raportim në ATK është nga 1 Janari deri me 31 Mars, për të aplikuar ju duhet të raportoni para datës së aplikimit në këtë grant skemë;*
32. Jam kompani që merrem me prodhimin e luleve dhe drunjëve dekorativ a mund të aplikojmë në grant për makineri për mbjelljen e luleve, saktësisht për transplantimin e fidanëve nga modulet në vazo?

- *Bujqësia nuk kualifikohet, shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4;*
33. Projekti i im ka të bëjë me tharjen e bimëve. Tharësja është në formë të serrës. Tharja e bimëve bëhet në mënyrë natyrale, Punohet identik me tharëset për kultivim të perimeve me ndryshim të vogël në pamje, por dallimi është se kjo mbulohet me plasmë të zi që është i posaçëm për këtë punë dhe brenda saj punohen raftet për tharje. A me lejohet financimi?
- *Bujqësia nuk kualifikohet, shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4;*
34. A mund të aplikoj për shpezëtari prodhimi vezëve në këtë grant e cila ndikon në uljen e importit dhe si bëhet mënyra e financimit gjatë realizimit të projektit?
- *Bujqësia nuk kualifikohet, shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4;*
35. Shpenzimet e përgatitura të planit të biznesit a janë të pranueshme si pjesë e projektit dhe nëse po sa është ajo?
- *JO;*
36. Ne si biznes jemi të regjistruar mbi 2 vite, mirëpo kemi interes për financim në vlerë rreth 7000 euro a kemi drejt të aplikojmë në Lot 2 edhe pse aty kërkohet që biznesi të jetë i regjistruar deri në 1 vit ?
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pika 1.5;*
37. Ne letrën informuese ceket që financohen edhe shërbimet afariste, ne jemi kompani e kontabilitetit a jemi të kualifikuar për te aplikuar si aktivitet .
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4 dhe pikën 2.6;*
38. Vitin e kaluar kam hapur një biznes për korniza dekorative, në pamundësi për të blerë pajisjet e duhura kam pritur për grante. A financohen pajisje për përpunimin e profileve dekorativ të drurit?
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4 dhe 2.6;*
39. Tek udhëzimet për aplikim Lot 1 me shumë (2000 - 5000 €) çfarë nënkuptojmë me "buxhet indikativ prej 20% nga shuma e alokuar" ?
- *Shuma totale e thirrjes për propozime të cilën e ka lansuar Ministria për Lot 1;*
40. Tek plotësimi i shtojcës B, buxheti, tek rubrika e "shpenzimeve tjera" a duhet shënuar shpenzimet tjera të biznesit duke përfshirë, (qiranë, shpenzimet e lokalit dhe lëndën e parë) apo duhet plotësuar vetëm rubrikën e parë "pajisjet" duke shënuar vetëm shpenzimet e pajisjeve që kërkojmë të financohen?
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pika 2.7;*
41. Tek shtojca C1, projektionet financiare lot 1, rreth pasqyrës së fitimit dhe humbjes 2017, ne jemi biznes i ri dhe nuk kemi aktivitet te mëparshëm a duhet mënjanuar kjo shtojce apo si duhet plotësuar?
- *Shiko plotësimet në thirrje për propozime të datës 07.02.2018 të publikuara në ueb faqen e MZHR-së;*
42. Tek shtojca D plani i veprimit, kërkohet kohëzgjatja projektit përbrenda 12 muajve ndërsa projekti jone është biznes me aktivitet të vazhdueshëm zhvillimor dhe me kohë të pacaktuar, a duhet shmangur kjo shtojce apo si duhet vepruar ? -
- *Kohëzgjatja e projektit duhet të jetë 6 muaj, si dhe shiko plotësimet në thirrje për propozime të datës 07.02.2018 të publikuara në ueb faqen e MZHR-së;*

43. Po e bej këtu pyetjen për arsye se me duhet me e ditë saktë a vlen kjo mënyrë apo jo. E kom një ide biznesi ne fushën e prodhimit, por për start up granti deri në 5000 euro nuk e mbërrin vlerën e projektit as për se afërmi. Me qene se ne idenë e biznesit parashihet edhe prodhimi i lëndës së parë dhe produkti. A ka mundësi që me një koleg timin ti bëjmë 2 biznes plane e që në fakt do të punojmë për një biznes. Mirëpo për ta fituar këtë grant jam i vetëdijshtëm që duhet te regjistrohen 2 biznese njeri për ta prodhuar lëndën e parë e tjetri për ta prodhuar produktin. Arsyeja e vetme është mbërritja e vlerës deri 10.000euro për arsye se vlera e projektit po na shkon në 16.000euro  
Fjala është për prodhim të peletit me një sasi për 1.5t/h (ton për orë) d.m.th. njeri biznes do ta bëj bluarjen e drurit edhe kthimin ne tallash dhe biznesi tjetër prodhimin e peletit por që do të operojmë me një objekt.  
Kemi bërë hulumtim tregu dhe del se ne Kosove 80% importohet nga jashtë e shumica nga Serbia. Pra pyetja konkrete a ka mundësi me u realizua në këtë mënyrë apo jo?

- *Aplikohen rregullat sipas udhëzuesit për aplikantë pika 1.5.;*

44. A mundem të aplikoj për përpunim të pemëve, perimeve, qumështit, mishit?

- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4. dhe pikën 2.6;*

45. A mund të aplikoj për ndërtimin e objektit si lloj restoranti, token e kam te gatshme po veç po me duhet objekti, unë gjithashtu kam edhe serrën ne te cilën vet i prodhojmë perimet. Perimet janë shume bio, dhe kemi shume kërkesa për to. Këto prodhime do ti shfrytëzojmë edhe ne kuzhinën te cilën po ëndërroj ta kem.

- *JO;*

46. A mund të blej pajisje si: furra, frigorifer, tertore dhe depo për ruajtjen e produkteve?;

- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4. dhe 2.6.;*

47. A duhet me pas NIF për me apliku?

- *NIF aplikohet për projektet e MBPZHR, kurse me rastin e aplikimit në MZHR do të merrni numrin e aplikimit dhe e gjithë komunikimi me aplikantin do të bëhet duke ju referuar numrit të aplikacionit;*

48. A mund të aplikoj si bletar?

- *Bujqësia nuk kualifikohet;*

49. Cilat projekte janë të ndaluara në bujqësi?

- *Bujqësia nuk kualifikohet si sektor;*

50. Më intereson informacioni sepse jam pak konfuz, ju për Lot 3 financoni vetëm deri në 50% të fondeve të kërkuara d.m.th. nëse shuma totale për projektin tim është 20,000 euro, ju miratoni 10,000 euro dhe pjesa tjetër bashkë financohet në shumën prej 10,000 euro?

- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 1.5.;*

51. Dëshiroj të aplikoj në Skemën për Lot 1, shuma e grantit që dëshiroj të kërkoj është në vlerë 4,700 euro ndërsa edhe pjesa ime e bashkëfinancimit është në vlerë 1,700 euro që gjithsej Plan Biznesi është në vlerë 6.400 euro. Pra përqindja e kërkuar është në vlerë 73.44 % ndërsa bashkëfinancimi 26,56 %. A është brenda kritereve shuma e kërkuar e projektit për Lot 1 ?
- *Kalkulimi është brenda kritereve të përcaktuara sipas udhëzuesit për aplikantë pika 1.5.;*
52. A mund të aplikojmë për blerje te makinave jashtë vendit pasi në Kosovë nuk ka të tilla?
- *Nuk ka kufizime vendi ku të blihen pajisjet, por duhet të jenë me vlera të tregut pasi që çmimet verifikohen;*
53. Ne kemi fituar Grant prej rreth 13,000 EUR nga ARDA vitin e kaluar dhe a na lejohet të aplikojmë përsëri pasi që në aplikim është pyetje nëse kemi fituar grant gjate 3 viteve të fundit?
- *Vetëm në rast se vërtetohet se përfituesi ka përfituar përkrahje për projektin e njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër;*
54. Ju lutem a ka drejt te aplikoj një biznes që bën therjen dhe paketimin e pulave për mish për disa makineri për procesin e paketimit dhe ruajtjes, si dhe a vlerësohet me më shumë poena nëse rritet kontributi i aplikuesit në maksimum deri në 40% sipas udhëzuesit.
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4. dhe 2.6.;*
55. A ka të drejtë aplikimi një ndërmarrje private (Lot 3) për shërbime profesionale të GIS (p.sh shërbimet të ju ofrohen ndonjë institucion publik)?
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.6.;*
56. Biznesi i mirëmbajtjes, mbjelljes dhe shitjes se luleve a hyn në kategorinë e bujqësisë për shkak që projektet nga lëmi e bujqësisë nuk financohen?
- *Bujqësia nuk kualifikohet, shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4;*
57. Çfarë nënkuptoni me shërbime komerciale? Cilat shërbime sipas autoritetit tuaj listohen në shërbime komerciale?
- *Shërbimet që ofrohen në këmbim të të hyrave/profitit.*
58. Bizneset aplikuese duhet të jenë të komunave: Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Pejë dhe Gjilan apo lejohen të jenë edhe të komunave si ajo e Ferizajt?
- *Mundësinë e aplikimit e kanë bizneset dhe aplikantët potencial nga i gjithë territori i Republikës së Kosovës.*
59. Te koha zgjatja e projektit duhet të planifikohet vetëm për 6 (gjashte) muaj dhe brenda kësaj periudhe duhet vetëm të planifikohet fillimi i fitimit apo brenda kësaj periudhe të planifikohet kthim i investimit?
- *Sa i përket kohëzgjatjes shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.3., kurse kthimi i investimeve paraqitet në shtojcën C 1 ose C 2 varësisht prej biznesit;*
60. A duhet që Pasqyra e të Ardhurave Financiare të bëhet për vitin 2018 (viti vijues), qe ne ketë rast po i bie parashikim për arsyeje se do te filloj për herë të parë këtë vit, e jo siç është në tabela (C1) për vitin 2017?

- *Shiko plotësimet në thirrje për propozime të datës 07.02.2018 të publikuara në ueb faqen e MZHR-së;*
61. A duhet të bëhet ndonjë Plan Biznesi i ndarë apo vetëm të plotësohet formulari i aplikimit me (te gjitha shtojcat) ku nënkupton edhe vete planin e biznesit?
- *Vetëm formularët dhe shtojcat e përcaktuara nga MZHR për këtë skemë të granteve;*
62. Te buxheti a duhet të përfshihen edhe shpenzimet të cilat nuk mbulohen nga MZHR si paga, uji , rryma. Apo këto duhet te përfshihen vetëm ne Pasqyrën e të Ardhurave për vitin vijues 2018?
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.7 si dhe aneksin C 1 ose C 2;*
63. Përshkrimi i njërive i detajuara te shtojca Buxheti çka nënkupton dhe si duhet të vepruar?
- *Përshkrimi i njërive të cilat parashihen të financohen nga ky projekt;*
64. A duhet me vetëfinancuar krejt projektin a duhet me dorëzuar faturat e ju me bërë pagesën?
- *Çështja e pagesave përcaktohet me kontratë;*
65. Nëse një ndërmarrje është me e vjetër se 2 vite, a do mund ajo që përsëri të aplikonte përmes Lot 2 për një shume më të vogël sesa 10,000 EUR ( le të themi 5,000 EUR) apo është e detyruar të aplikojë përmes Lot 3 në bazë të viteve të operimit?
- *Aplikohen rregullat sipas udhëzuesit për aplikantë pika 1.5.;*
66. Nëse keni mundësi të na sqaroni rreth plotësimit të ProjekSIONIT Financiar Lot3, ne kemi shënuar shifrat e sakta për vitin 2017 por për vitet 2018/19 çfarë duhet të bëjmë ti shënojmë pritjet gjatë këtyre viteve pas investimit apo çfarë të shënojmë.
- *Shiko plotësimet në thirrje për propozime të datës 07.02.2018 të publikuara në ueb faqen e MZHR-së;*
67. A mundem me aplikua për me marrë grand për frigorifer ku mundet me qëndrua qumështi gjatë deri sa të dërgoj në qumështore e kam fjalën me ditë me qëndrua pasi që unë e kam një mini fermë të lopëve?
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4. dhe 2.6;*
68. ProjekSIONI Financiar a duhet të kalkulohet prej muajit në të cilin fitohet granti p.sh nëse fitohet në muajin qershor me kalkulua deri me 31.12.2018. Apo kalkulohet mbi 12 muaj pa marre parasysh në cilin muaj fillon me aktivitetin afarist?
- *Shiko plotësimet në thirrje për propozime të datës 07.02.2018 të publikuara në ueb faqen e MZHR-së;*
69. Ku është dallimi në mes të Planit të Veprimit (12 muaj) edhe te Kohëzgjatja e Planifikuar e projektit që financohet nga MZHR e cila nuk mund të tejkalojë 6 muaj (nuk mund ta bej dallimin)?
- *Shiko plotësimet në thirrje për propozime të datës 07.02.2018 të publikuara në ueb faqen e MZHR-së;*
70. Plani i Veprimit a ka të bëj vetëm me implementimin e projektit dhe jo edhe me fillimin e procesit të aktivitetit afarist.

- *Aktivitetet e përcaktuara në planin e veprimit duhet të korrespondojnë me aktivitetet e përshkruara në aplikacion, shiko Shtojcën D Plani i Veprimit;*
71. A duhet të plotësohet Plani i Veprimit duke supozuar që është fituar granti dhe fillohet me implementimin e projektit për 12 muaj (pa marrë parasysh vitin fiskal/kalendarik)?
- *Në plan të veprimit paraqitet për sa muaj do të arrini ju ta realizoni projektin p.sh 1, 2, 3, 4, 5 ose 6 muaj;*
72. Në rast se mund të gjejmë pajisje të përdorura me një çmim më të arsyeshëm dhe me faturë të rregullt, a llogaritet si shpenzim i pranueshëm sa i përket grantit?
- *JO;*
73. Pro faturën nëse e kam me TVSH , a mund të llogaritet që bashkëfinancimi im si aplikant do të jetë pagesa e shumës së TVSH-se që figuron në faturë apo bashkëfinancimi duhet të jetë në vlerën pa TVSH, se biznesi im nuk është në TVSH?
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.7;*
74. A pranohen për kualifikim bizneset që japin shërbime të mirëqenies si ushtrime fizioterapeutike ose edhe ato të fitnes-it?
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pikën 2.4 dhe pikën 2.6;*
75. Tek formulari i aplikimit çfarë duhet shënuar në rubrikën "Përqindja e grantit në vlerën totale të projektit" e cila gjendet nën rubrikën "shuma e grantit të kërkuar"?
- *Kjo nënkupton pjesëmarrjen e grantit (pjesa që financohen nga MZHR) në vlerën e projektit në %;*
76. Tek shtojca D plani i veprimit, që thotë: "Kohëzgjatja e veprimit do të jetë maksimum 12 muaj" . Aplikacioni ynë kërkon financim të një pajisje për një aktivitet / biznes afatgjatë, si duhet plotësuar kjo shtojcë?
- *Në plan të veprimit paraqitet për sa muaj do të arrini ju ta realizoni projektin p.sh 3,4,5 deri në 6 muaj, shiko plotësimet në thirrje për propozime të datës 07.02.2018 të publikuara në ueb faqen e MZHR-së;*
77. Kërkesa e pikës së tretë (Të jetë në gjendje të demonstrojë likuiditetin e kompanisë. Apo likuiditetin potencial ) Kompania nuk ka qarkullim prandaj pasqyrat janë me zero, po ashtu dhe tatimi e obligimet?
- *Kapaciteti financiar vlerësohet në bazë të raporteve/pasqyrave të deklaruara në ATK;*
78. Çka nënkuptojmë me buxhet indikativ si dhe buxhet indikativ për prej 50% nga shuma e alokuar Loti 3 - Ndërmarrje të vogla (mbi 2 vjet)?
- *Me buxhet indikativ nënkuptohet shuma totale e alokuar për tre Lot-et të buxhetit të kësaj grant skeme që do të financohet nga MZHR-ja;*
79. Kontributin në natyrë? Çka cilësohet kjo ose si çka definohet?
- *Kontribut në natyrë është kapitali që nuk është në para të gatshme;*
80. Ndërmarrje e vogël e cila mund te aplikoj ne LOT 3; çka nënkupton?
- *Shiko Ligjin Nr. 03/L-031;*



81. Në rast se unë aplikoj për grant 20 mijë euro dhe bashkë financoj me 40% ose 13333 euro dhe vlera e faturës e kalon këtë shumë totale me TVSH, si e trajton MZHR pagesën e kësaj fature?
- *Për bizneset që janë deklarues të TVSH-së shiko udhëzuesin për aplikantë pika 2.7.;*
82. Ne jemi një kompani e posa formuar që ofrojmë shërbime komerciale si: kontabilitet, marketing dhe kryesisht shërbime financiare. Ideja jonë është që të punësohemi fillimisht katër persona ku mosha jone varion nga 22-28 vjeç. Ne planifikojmë të zhvillojmë biznesin tone duke i ofruar shërbimet tona për shtetet perëndimore dhe pastaj të rritemi deri në fund të vitit 2018 në dhjetë persona. Kemi kontaktuar me disa kompani nga jashtë për te ju ofruar këto shërbime dhe kemi marrë premtime që do të bashkëpunojmë së bashku, gjithashtu në do të shtrihemi dhe në tregun vendor. Mirëpo pasi që jemi biznes i posa themeluar si fazë fillestare neve po na duhet me investua në **asete të prekshme** dhe për ne si biznes i ri janë gjera qe kushtojnë si p.sh: Llap Topa, Printer, Softuerë për Kontabilitet dhe për Marketing, Tavolina dhe karrige të punës etj. A kemi të drejt të aplikojmë në këtë grant.
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pika 2.4 dhe 2.6;*
83. Biznesin e kam te regjistruar me datën 30.06.2016 edhe pse si biznes ka qene i themeluar nga fillimi i vitit 2015, mirëpo i pa regjistruar deri në datën e lartë cekur. Ju lutem a mund te me tregoni a i plotësoj kushtet për aplikim ne LOTIN 3 pasi sipas udhëzuesit për Aplikim ne LOTIN 3, janë Ndërmarrje te vogla (Mbi dy vjet), te cilin kusht sipas datës se regjistrimit se plotësoj mirëpo nga themelimi i biznesit kanë kaluar mbi dy vjet.
- *Data e kalkulimit të viteve merren data e lansimit të thirrjes për propozime për këtë skemë të granteve 25.01.2018;*
84. A kam drejt te aplikoj me projekt që ka të bëj me prodhimin e dyerve dhe dritareve roleta te plastikës dhe a pranohet ky projekt që është prodhim?
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pika 2.4. dhe 2.6;*
85. Unë jam duke e zhvilluar biznesin ne sektorin e blegtorisë - (bletari) tash e dy vite, ju lutem a mundem me apliku për pajisje të paketimit për shitje në paketime të vogla për bizneset hoteliere?
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pika 2.4. dhe 2.6;*
86. A financohet projekti i cili ka të bëjë me blerjen e pajisjeve për hapjen e biznesit "stiliste e manikyr pedikyr"?
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pika 2.4. dhe 2.6;*
87. A financohet projekti për prodhimin e qeseve leter që shërben për produktet e miellit si dhe të tjera?
- *Shiko udhëzuesin për aplikantë pika 2.4. dhe 2.6.*